



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 130/4 Prot.

Tiranë, më 25/02 2022

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

TIRANË

Lënda: Mbi Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2021.

Në mbështetje të Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Aktit Normativ, nr. 26, datë 22.06.2021 dhe nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, si dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr.4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2021 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të vitit 2021, krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Valbona GAXHA



PËRMBAJTJA	Faqe
Hyrje	2
Raport i monitorimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2021	2-3
Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2021	3-8
Analiza e objektivave institucionale të KLSH-së, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.	8-10
Mbi realizimin e objektivave të menaxhimit institucional	10-16
Aneksi Nr. 1 Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve.	17
Aneksi Nr. 2 Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë.	18
Aneksi Nr. 3 Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit.	19
Aneksi Nr. 4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.	20
Aneksi Nr. 5 Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.	21

HYRJE

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të vitit 2021, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022.

Në mbështetje të Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Aktit Normativ, nr. 26, datë 22.06.2021 dhe nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për vitin 2021, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2021-2023 dhe është në funksion të kësaj Deklarate.

Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2018-2022, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integritimit Evropian.

Përgjatë vitit 2021 KLSH vijon me ushtrimin e veprimtarisë institucionale në përmbushje të objektivave prioritare strategjike të zhvillimit institucional, që konsistojnë në:

- 1.Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të.
- 2.Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.
- 3.Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Për sa i përket kërkesave buxhetore, duke vlerësuar dhe gjendjen aktuale financiare, menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike që KLSH ka programuar në harkun kohor 2021-2023 në planin strategjik institucional në drejtimet e mëposhtme:

-Fokusi në rritje drejt auditimit të performances, duke synuar rritjen e numrit dhe të cilësisë të auditimeve të performancës, në funksion të arritjes së parametrave të SAI-ve homologe, shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukurore për këtë lloj auditimi, asistimin në formulimin e parametrave të performancës në sektorë të administratës publike etj.

-Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (certifikimi i pasqyrave financiare) dhe shtimi i numrit të auditimeve financiare.

- Konsolidimi i Auditimit te Përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesave ISSAI-ve.
- Thellimi në auditimin e teknologjisë së informacionit shtimi i numrit të auditimeve IT dhe konsolidimi i cilësisë nëpërmjet zbatimit të Standarteve Ndërkombëtare ISSAI.
- Rritjen e performancës së veprimtarisë audituese përmes forcimit të kapaciteteve institucionale të KLSH.
- Përmirësimin e metodologjive/manualeve të auditimit, duke zhvilluar dhe metodologji të veçanta, si ajo e auditimit të mashtrimit financiar, integritetit dhe etikës.
- Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve dhe optimizimit të kapaciteteve profesionale.
- Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit te metodologjive dhe standardeve profesionale të aplikueshme në përputhje me praktikat më të mira të komunitetit të INTOSAI-t.
- Zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
- Zhvillimin dhe kualifikimin e burimeve njerëzore konform implementimit të Dokumentit të Politikës së Burimeve Njerëzore ne KLSH miratuar me Vendim të Kryetarit nr 128 datë 31.12.2017.
- Rritjen dhe konsolidimin e cilësisë së botimeve me materiale që i shërbejnë procesit të auditimit etj.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2021”

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, dhe Aktit Normativ, nr. 26, datë 22.06.2021 dhe nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, është bërë miratimi i çeljes dhe rishikimit të fondeve buxhetore për vitin 2021, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2021, paraqiten si më poshtë:

Art.	Përshkrimi I Artikullit	Buxheti Faktik 2020	Buxheti fillestar vjetor	AN nr.26, dt. 22.06.2021	AN nr.34, dt. 03.12.2021	Në mijë lekë		
						Fakti 2021	Plan/ Fakt	%
1	2	3	4	5	6	6	7	8
600	Paga	257,973	269,000	273,000	253,000	247,281	5,719	97.7
601	Sigurime Shoqërore	40,143	42,000	42,000	42,000	40,073	1,927	95.4
	Paga dhe Sigurime	298,116	311,000	315,000	295,000	287,354	7,646	2
602	Mallra dhe Shërbime	50,823	80,850	80,850	52,850	51,593	1,257	97.6
605	Transferta Korr. të Huaja	118	150	150	150	61	89	40.7
606	Transferta Korente	2,160	1,847	1,847	1,847	1,273	574	68.9
	Shpenzime Korrente	53,101	82,847	82,847	54,847	52,927	1,920	96.5
230+231	Invest. Financim Brendshem	13,764	20,000	20,000	20,000	7,586	12,414	37.9
231	Invest. Fincim i Huaj		19,853	19,853	19,853	0	19,853	0.0
231	Grande				1,383	1,115	268	80.6
	Shpenzime Kapitale	13,764	39,853	39,853	41,236	8,701	32,535	97.7
Totali	Korrente dhe Kapitale	364,981	433,700	437,700	391,083	348,982	42,101	97.7

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR VITIN 2021

Bazuar ne Ligjit 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” KLSH për vitin 2021 u miratua fondi në total në vlerën 433,700 mijë lekë.

-Me Aktit Normativ, nr. 26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, buxheti i KLSH-së, është në shtuar në vlerën për 4,000 mijë lekë në zërin “Paga dhe Sigurime” duke kaluar kështu në vlerën për 437,700 mijë lekë dhe

njëkohësisht numri i të punësuarve është rritur me 15 persona, pra në total numri i të punësuarve për KLSH-në është **218 punonjës**.

-Me Aktin Normativ, nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, buxheti i KLSH-së, është pakësuar në vlerën për 48,000 mijë lekë dhe konkretisht zëri “Paga dhe Sigurime” në vlerën për 20,000 mijë lekë dhe zëri “Mallra dhe shërbime” në vlerën për 28,000 mijë lekë . Gjatë vitit 2021, buxheti i KLSH-së është shtuar në vlerën për 1,838 lekë në zërin “Grande nga donatorë të huaj”, duke kaluar kështu në vlerën totale për **391,083 mijë lekë**.

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2021 në Ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 311,000 mijë lekë.

Për vitin 2021, fondi i shpenzimeve për “Paga dhe Sigurime ”i programuar në vlerën për 295,000 mijë lekë, sipas Aktit Normativ, nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, është realizuar në vlerën për 287,354 mijë lekë. ose janë realizuar në masën 97,4%.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2021 në Ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 80,850 mijë lekë, ose 19% e planit buxhetor të vitit 2021.

Për vitin 2021, fondi i shpenzimeve operative i programuar në vlerën për 52,850 mijë lekë, sipas Aktit Normativ, nr. 34, datë 03.12.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020 “ Për buxhetin e vitit 2021”, është realizuar në vlerën për 51,593 mijë lekë. ose janë realizuar në masën 97,6%.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit në vlerën për 34,370 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 67% të shpenzimeve faktikë të këtij zëri.

3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2021, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 61.2 mijë lekë nga 150 mijë lekë të planifikuara.

4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2021, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,847 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje dhe është realizuar në masën 1,273 mijë lekë ose realizuar në masën 68,9%.

5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 39,853 mijë lekë, nga të cilat 20,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm dhe 19,853 mijë lekë për investime kapitale me Financim të Huaj.

Tabela në vijim paraqet, planin vjetor dhe realizimin e Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm dhe të Huaj për vitin 2021.

Shpenzime për Investime Kapitale

A-Financim i Brendshëm

Nr.	Pershkrimi	Në mijë lekë
		Vlera
1	Rinovim License Fireçall dhe e-mail security	1,640
2	Dizenjim, zhvillim, imlementim dhe mirembajtja e faqes Eeb te KLSH	613
3	Sëitch Layer	443
4	Blerje Antivirus	204
5	Paisje sigurie/kamera te jashtme	144
6	Fotokopje Xerox	357
7	kasaforte	117
8	Hard Disk	28
9	Sëitch	18
10	Vidio Regjistrator	36
11	Instalim dhe konfigurim paisjesh	73
14	Rikonstruksion godina	1,420
15	Blerje dere	100
16	Paisje lavaxhi	75
17	Fshese Pastrimi Elektrike	18
18	Kosto Lokale	2,300
	Totali I investimeve	7,585

Aktualisht, për vitin 2021, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me: Blerje shërbim interneti për parkun e automjeteve të institucionit. Me qëllim rritjen e sigurisë në ambientet e parkut të automjeteve për të bërë të mundur shfrytëzimin e këtyre ambienteve me qëllim përdorimin me efikasitet të të gjithë asetëve të institucionit nga institucioni u ndërmor kjo procedurë prokurimi. Për këtë qëllim ka qenë e nevojshme dhe domosdoshmëri blerja e shërbimit të internetit për parkun e automjeteve të KLSH-së.

Blerje licenca të Firewall dhe E-Mail Security në vlerën për 1,640 mijë lekë. Platforma informatike që përdor Kontrolli I Lartë I Shtetit, është e ngritur bazuar në teknologjinë e virtualizimit. 3 server fizikë janë hostues të 12 makinave virtuale përmes të cilave kryhet menaxhimi i të gjithë shërbimeve teknologjike të nevojshme për plotësimin e kërkesave dhe nevojave nga ana informatike të institucionit. Këta servera mbrohen përmes pajisjes Fireçall e cila ka një licencë përkatëse suporti i të cilës ka afat kohor 1-vjeçar. Gjithashtu, në infrastrukturën informatike të KLSH, është implementuar një softëare për mbrojtjen e komunikimit elektronik (e-maile) e cila gjithashtu funksionon nën një licencë. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

Blerje Fotokopje: në vlerën për 357 mijë lekë. Ky prokurim është kryer pasi bën të mundur ofrimin e mbështetjes në printim të dokumentacionit që krijon gjatë proceseve të punës Kontrolli i Lartë i Shtetit. Këto pajisje janë gjykuar si të domosdoshme pasi nga vlerësimi i kryer ka rezultuar se institucioni ishte i pajisur me 2 copë Fotokopje Multifunction Color MFD Basic të cilat janë prokuruar në vitin 2015 dhe kanë amortizim moral dhe fizik 5-vjeçar. Gjithashtu ka shërbyer në ndihmë të institucionit duke marrë parasysh rritjen e fluksit të dokumentacionit që prodhohet nga institucioni.

Blerje sistem vëzhgimi në vlerën për 299 mijë lekë. Deri në fillim të vitit 2021, institucioni nuk kishte asnjë sistem vëzhgimi të dokumentuar në përdorim, për mbulimin me pamje

filmike të ambienteve të parkut të mjeteve të KLSH-së. Prokurimi i një sistemi vëzhgimi me kamera për ambientet e parkut të automjeteve ka shërbyer për të rritur nivelin e sigurisë në funksion të mbrojtjes së aseteve të institucionit. Ky sistem ka shërbyer dhe ka vazhdon të shërbejë për institucionin për të garantuar mbrojtjen e sigurisë fizike të ambienteve të parkut si dhe të automjeteve në pronësi të institucionit.

Dizenjim, zhvillim, imlementim dhe mirëmbajtja e faqes Eëb te KLSH në vlerën për 791 mijë leke. KLSH ka si objektiv përdorimin e teknologjisë së informacionit duke aplikuar standardet dhe praktikat më të mira bashkëkohore dhe synon të jetë në përputhje me zhvillimet e teknologjisë. Gjithashtu, duke pasur parasysh ndryshimet në menaxhimin e institucionit dhe qasjen menaxheriale, si dhe me qëllim përmirësimin dhe modernizimin e teknologjisë së përdorur për zhvillimin dhe menaxhimin e faqes web që KLSH ka në përdorim lindi si domosdoshmëri realizimi i procedurës 'Dizenjim, zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje e faqes Eëb të KLSH-së'.

Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme të KLSH-së, në vlerën për 2,606 mijë lekë.

Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme erdhi si domosdoshmëri pasi me Aktin Normativ të KM, nr. 26, datë 22.06.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar", për KLSH, është miratuar një shtesë në numrin e punonjësve për 15 punonjës, pra numri i punonjësve të miratuar për KLSH, për vitin **2021 është 218 punonjës**. Fondet për këtë qëllim janë siguruar nga fondet e miratuara për "Pajisje informatike", kjo pasi KLSH ka rezultuar me një kursim fondesh në vlerën për 3,015 mijë lekë nga kryerja e procedurave të prokurimit si dhe për arsye objektive ka anuluar një procedura prokurimi të këtij zëri.

Për vitin 2021, KLSH ka prokuruar fondet në vlerën 9,700 mijë lekë për blerje makine, por kjo procedurë prokurimi për vitin 2021 nuk ka rezultuar e suksesshme.

Kosto lokale për vitin 2020 është realizuar në vlerën për 2,300 mijë lekë. Drejtoria e Fondit Kombëtar me shkresën nr. 4146, datë 01.03.2021 protokolluar në KLSH nr. 318, datë 03.03.2021, ka përcjellë kërkesën për transferimin e shumës prej 54,141.36 Euro në llogarinë e Fondit Kombëtar. Kjo shumë lidhet me fondet e financuara nga Bashkimi Evropian për projektin e binjakëzimit "*Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm*". Ky projekt është implementuar në KLSH në periudhën 16 mars 2016- 13 korrik 2018 dhe është financua nga Bashkimi Evropian në vlerën 2 milion euro dhe 100 mijë euro nga Buxheti i Shtetit. Pas përfundimit të implementimit të projektit nga Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga BE është kryer auditimi edhe për këtë projekt duke lënë rekomandim për CFCU-së (Centrale Finance and Contracting Unit), strukturë e Ministrisë së Financave "*Kontrata e financiar vetëm nga kontributi i BE-së duhet të rillogaritet në përputhje me parimin e bashkëfinancimit të përbashkët dhe pjesa e lidhur me Kontributin Kombëtar në përputhje me marrëveshjen financiare do të rimbursohet nga buxheti kombëtar*"

B-Financim i Huaj

B.1 Gjatë periudhës Gusht 2021, në bankën e nivelit të dytë për KLSH-në janë arkëtuar në llogarinë 72111100 në kredi të të ardhurave nga donatori INTOSAI , vlera për **1,383 mijë lekë**.

Qëllimi i **Grantit** është që të sigurojë mbështetje afatshkurtër përmes zgjidhjeve të TIK-ut, trajnimeve dhe pajisjeve të sigurisë së stafit për të mundësuar vazhdimësinë e operacioneve të SAI të ndikuara nga COVID-19. Për t'u marrë parasysh për këtë grant SAI duhet të jetë anëtar i INTOSAI.

Fondeve të këtij granti janë prokuruar dhe realizuar në vlerën për **1,115 mijë lekë** me qëllim blerjen e pajisjeve kompjuterë desktop që do të shërbenin për të mbështetur auditorët e KLSH. Këto fonde janë përdorur nga KLSH Në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, Kontrolli i Lartë i Shtetit Shqiptar, që nga viti 2018 ka në përdorim një sistem kompjuterik që shërben për menaxhimin e informacionit. Ky sistem ndihmon auditorët e SAI -t të menaxhojnë dokumentacionin dhe orientojnë drejtuesit e lartë për të analizuar dobësitë dhe për të pasqyruar në kohë reale statusin dhe zhvillimin e projekteve të auditimit. Prokurimi i paisjeve kompjuterëve do të mundësojë rritjen e nivelit të përdorimit dhe krijimin e lehtësive për funksionimin e duhur të këtij sistemi, duke bërë të mundur rritjen e numrit të auditorëve që do të përdorin sistemin e informacionit SIMMPA, në njësinë e kohës. Përdorimi i këtij kompjuteri do të zvogëlojë kohën fizike të auditorëve duke përdorur kohën në mënyrë efikase për të rritur performancën e procesit të auditimit. Në rastin e KLSH, duke marrë parasysh faktin se institucioni nuk ka tenderuar kompjutera desktop, që nga viti 2018, blerja e kompjuterëve do të mundësojë reduktimin e kohës së përpunimit të të dhënave përmes sistemeve të TI, duke bërë të mundur që auditorët të përqëndrohen dhe të thellohen në punë auditimi.

B.2 Bazuar në Ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 231 është miratuar në vlerën **19,853 mijë lekë** dhe është parashikuar për zbatimin e projektit, “**Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri**”. Për vitin 2021, KLSH, ka hapur procedurën e prokurimit për këtë projekt por që kjo procedurë prokurimi në mbyllje të periudhës ushtrimore nuk u bë e mundur të realizohej. Projekti “Forcimi i kapaciteteve në auditimin e prokurimeve publike, koncesioneve dhe PPP-ve” është përgatitur nga KLSH qysh në vitin 2016, si pjesë e aplikimit për mbështetje nga INTOSAI - IDI Donor Cooperation.

Projekti u shpall fitues nga IDI, të cilët e referuan propozimin tek Banka Botërore nën Programin SAFE, por për shkak të numrit të lartë të aplikimeve KLSH-së iu sugjerua kontaktimi me zyrën e SECO (Sëiss State Secretariat for Economic Affairs).

Pas takimeve dypalëshe të realizuara kryesisht gjatë fund vitit 2019, u dakordësua për financimin e projektit në shumen totale prej 264’000 USD, prej të cilave 239’100 USD janë financim i SECO dhe 24’900 USD (10% e vlerës) financim nga buxheti i shtetit për KLSH-në. Projekti do të ketë një kohëzgjatje 2 vjeçare dhe marrëveshja për fillimin e tij u nënshkrua në ambientet e KLSH-së, në datën 9 mars 2020 nga Kryetari i KLSH-së, dhe nga Ambasadori i Konfederatës Zvicerane në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien qeveritare në përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, duke përdorur mjete IT në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira profesionale për sektorin publik.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP). Ky projekt do të bëjë të mundur krijimin e eksperiencave të reja dhe do të përsosë njohuritë dhe aftësitë e audituesve të KLSH-së për të mbikëqyrur fushën e koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik-privat duke sjellë dhe plotësimin e një kornize të përshtatshme për të siguruar që këto lloj kontratash ofrojnë vlerë të shtuar dhe minimizojnë risqet në kushtet e financimit publik. I gjithë ky proces nuk mund të bëhet pa

garantuar që audituesit kanë aftësitë e duhura teknike lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në auditim.

Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publike përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë dukshëm në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

Bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) i Konfederatës zvicerane do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së, por do të jetë njëkohësisht edhe promotori i mbështetjes së Konfederatës së Zvicrës për Republikën e Shqipërinë. Ky projekt do të prokurohet nga KLSH përgjatë vitit 2022.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-SË, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER PERIUDHEN E VITIT 2021

KLSH përgjatë vitit 2021 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-SË

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në katër nene të saj ka qartësisht të shprehur misionin dhe nivelin pavarësisht të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat formëzojnë identitetin institucional të tij. Ky mision dhe funksionimi institucional janë strukturuar dhe sanksionuar në detaje në Ligjin nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi bazën e të cilave janë ndërtuar të gjitha aktet rregullative institucionale dhe metodologjike të institucionit.

Misioni i KLSH-së

KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që të shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Në përmbushje të kërkesave ligjore, standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të institucioneve supreme të auditimit të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t si dhe akteve rregullatore, KLSH kryen auditime financiare, të përputhshmërisë, të rregullshmërisë, të performancës, të teknologjisë së informacionit, si edhe ndërmerr vlerësime të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe njësisë të auditimit të brendshëm të strukturave qeverisëse dhe ente të tjera publike.

KLSH ka funksionuar do të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi, në shërbim të qytetarit dhe të qeverisjes së mirë, duke reflektuar vlerat dhe parimet e një SAI modern,

anëtar i komunitetit të INTOSAI-t i udhëhequr nga motoja “*Të gjithë të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri*”

Vizioni shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në vlerësime dhe konstatime. Audituesit e jashtëm publikë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve publike të audituara për të maksimizuar vlerën e parasë publike.

Vizioni i KLSH-së

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.

Misioni dhe vizioni orientojnë mënyrën sesi institucioni duhet të performojë për të: garantuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të tjera të sektorit publik; nxitur llogaridhënien para Parlamentit dhe rritur transparencën për qytetarët; duke qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmbush misionin dhe realizon veprimtarinë në zbatim të tetë parimeve: Pavarësia; Profesionalizmi; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Integriteti; Objektiviteti; Interesi Publik; Transparenca

Zhvillimi i KLSH mbështetet në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Institucionit të miratuar nga Kryetari KLSH, për periudhën 2018-2022. Në këtë strategji KLSH ka përcaktuar Misionin dhe vizionin institucional të së ardhmes. Objektivi i ISSAI-t 12, sipas të cilit “*SAI duhet të jetë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit*”, përbën boshtin mbi të cilin është hartuar Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së dhe që synon të sigurojë: transparencën dhe përgjegjshmërinë e duhur; qeverisjen e mirë; pajtueshmërinë me Kodin e Etikës; ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet promovimit të të mësuarit dhe shpërndarjes së njohurive.

Kështu, për qëllimin e parë strategjik “*Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të*” janë përcaktuar si objektiva:

- Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH;
- Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit;
- Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit;
- Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës;
- Thellimi në auditimin e Teknologjisë së Informacionit;
- Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesat e ISSAI-ve
- Cilësia si prioritet i KLSH - përmirësimi i cilësisë dhe përfitimi nga auditimet e KLSH;
- Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, rritja e nivelit të rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara;
- Rritja e impaktit të raportimeve nëpërmjet rritjes së përdoruesve të produkteve të KLSH-së; dhe
- Roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit.

Qëllimi i dytë strategjik “*Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese; procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse*” ka si objektiva:

- Korniza e Matjes së Performancës - si mjet vlerësimi dhe faktor zhvillimi të veprimtarisë së KLSH-së;
 - Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive dhe standardeve të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mira të profesionit;
 - Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet kultivimit të kulturës të të mësuarit gjatë gjithë jetës;
 - Forcimi i sistemit të strukturuar të edukimit profesional nëpërmjet certifikimit të audituesve publikë dhe zhvillimit të vazhdueshëm;
 - Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i dokumentit të politikave të burimeve njerëzore të KLSH-së.
 - Integriteti si vlerë themelore
 - Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Për qëllimin e tretë strategjik *“Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit”* është përcaktuar realizimi i objektivave;
- Konsolidimi i marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin;
 - Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë për komunikim të KLSH-së;
 - Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Objektivat e KLSH-së

Objektiv i vazhdueshëm i *KLSH-së* është të jetë një faktor profesional aktiv dhe partnerë për fuqizimin e mirëqeverisjes financiare dhe llogaridhënies publike në funksion të promovimit të transparencës, eficiencës dhe efektivitetit. Në këtë kuadër thellimi i luftës kundër korrupsionit është në fokus të veprimtarisë institucionale. Edhe gjatë vitit 2021, objektivat institucionalë në të cilin fokuson aktivitetin KLSH-së, konsistojnë në:

Sfida për orientimin e auditimit bazuar në riskun e gabimeve, mashtrimit dhe korrupsionit është adresuar nëpërmjet zhvillimeve dhe përmirësimeve të metodologjisë, duke u përqendruar në auditimin e sektorëve të ekonomisë me ekspozim më të lartë ndaj këtyre risqeve.

Konsolidimi dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës përmes zgjerimit të temave të fokusimit dhe të rritjes graduale të kapaciteteve profesionale dhe numerike të departamentit. Zhvillimi dhe rritja e numrit të auditimeve financiare, dhënia e opinionit për pasqyrat financiare si një hap më tej drejt përmbushjes së objektivit për rritjen e numrit të auditimeve financiare.

Konsolidimi dhe modernizimi i qasjes për auditimet e përputhshmërisë në të njëjtën linjë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

Rritja e cilësisë dhe e numrit të auditimeve IT, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të auditimit IT. Rritja e besueshmërisë tek institucioni suprem i auditimit, vlerësuar nga perceptimi i qytetarëve është një tregues se auditimet dhe raportimet janë kryer me integritet dhe profesionalizëm të lartë, etj.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

Kontrulli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik, për periudhën janar - dhjetor 2021 ka vijuar punën audituese për kryerjen e 158 misioneve të auditimit, nga të cilat duke u orientuar drejt përmbushjes së detyrimeve ligjore janë evaduar 158 misione auditimi.

158 misionet e auditimit të evaduara janë detajuar si më poshtë:

- 56 auditime përputhshmerie

- 41 auditime përputhshmërie dhe financiare¹²
- 18 auditime performance
- 21 auditime financiare
- 17 auditime tematike
- 5 auditime IT

Mbulimit me auditim të të gjithë aspekteve të domosdoshme, duke përmbushur shtrirjen e auditimeve, ku përgjatë vitit 2021 rezultojnë të evaduar 158 auditime në numër dhe sipas llojeve e departamenteve, duke realizuar projeksionet për numrin e angazhimeve audituese në institucionet e qeverisjes së përgjithshme, në njësitë e pushtetit vendor, në administratën tatimore dhe doganore, në shoqëritë me kapital shtetëror, etj. Në këtë prizëm:

A. Auditime Financiare me Opinion:

Në linjë me sugjerimet dhe rekomandimet e raport progresit të BE për auditimin e jashtëm publik, si dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, në akord me praktikat më të mira të kohës, është shtuar vëmendja ndaj auditimeve financiare me dhënie opinionimi mbi rregullshmërinë dhe besueshmërinë e pasqyrave dhe deklaratave financiare të entiteteve të audituara, në referencë me standardin ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”. Kështu, në vitin 2021 u përmbyllën 21 auditime financiare me dhënie opinionimi, ose e thënë ndryshe, dhe 37 opinione financiare nga auditimet mix.

Nga këto auditime në 17 raste ose 29 % të këtyre angazhimeve janë dhënë opinione të pakualifikuara. Opinioni ka qenë i kualifikuar në 25 subjekte ose 43 % të këtyre auditimeve, ndërsa në 16 raste ose 27%, grupi i auditimit të KLSH ka arritur në konkluzionin e një Opinioni të Kundërt.

B. Auditime të përputhshmërisë me Opinion:

Bazuar në planin vjetor të auditimeve, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2021, KLSH ka kryer auditime përputhshmërie 56 dhe 37 opinione përputhshmërie nga auditimet mix, nga të cilat për 10 raste janë dhënë opinione të pakualifikuara; në 55 raste opinionimi ka qenë i kualifikuar, ndërsa në 27 raste konkluzioni ka qenë për Opinion të Kundërt.

Puna audituese për 12 mujorin 2021 kanë pasur objektiv identifikimin e shkeljeve dhe raportimin e tyre në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik³ dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike nga subjekteve nën auditim⁴.

Puna audituese është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe gjatë kësaj periudhe, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë proceduriale dhe ineficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjislacionit fiskal.

Niveli i dëmeve ekonomike dhe shpenzimeve joefektive të konstatuara nga KLSH gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Shkeljet me dëm ekonomik⁵

¹KLSH ka kryer 41 auditime rregullshmërie, klasifikuar si auditime mikse, për të cilat janë dhënë 37 opinione për pasqyrat financiare dhe 37 opione përputhshmërie.

²Në auditimin e zhvilluar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës është dhënë dhe opinion për pasqyrat financiare edhe për Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Durrës.

³Dëmi ekonomik në aktivitetin auditues i referohet detyrimit të shpërbllimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet autoritetit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

⁴Efektin negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

⁵Kursi i këmbimit të lekut/euro është kursi i Bankës së Shqipërisë i datës 31.12.2021, 1 euro= 121 lekë.

-Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej **19,158,985 mijë lekë ose 158.3 milionë euro**.

-Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej **55,444,914 mijë lekë, afërsisht 458.2 milionë euro** nga e cila:

I. **10,948,006 mijë lekë** në fushën e të ardhurave, afërsisht **90.4 milionë euro**;

II. **44,496,908 mijë lekë afërsisht 367.7 milionë euro**, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës financiare lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara, i referohen përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në fushën e prokurimit publik shoqëruar me mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit, të cilat në shumë raste rezultojnë të realizuara jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2018-2020 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

Indikatori i dobishmërisë

Indikatori i dobishmërisë së auditimeve të realizuara, e reflektuar kjo si në vlerën e gjetjeve, numrin e rekomandimeve të lëshuara dhe masa vetë zbatuara nga entitetet publike të audituara, por edhe në efektin e zbulimit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjshmërisë. Treguesi i dobishmërisë së auditimit njihet si raporti i sasisë së fondeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga SAI me shpenzimet buxhetore fakti këtë institucioni dhe është një nga treguesit më domethënës të performancës së Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Shtetëror.

Për vitin 2021 rezulton se indikatori I dobishmërisë është 56, cka do të thotë se për çdo një lek të shpenzuar për KLSH-në nga Buxheti I Shtetit janë zbuluar nga auditimet e kryera 56 lekë.

Treguesi i dobisë së auditimit llogaritet si raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH në vlerën 19,158,985,000 lekë me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 340,281,749 lekë.


Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Në periudhën janar – dhjetor 2021, auditimet kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 205 subjekte (një institucion mund të jetë audituar dy ose më shumë nga KLSH për arsye të llojeve të ndryshme të auditimeve të ushtruara): institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki), drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, fonde speciale, si dhe shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shpërndarja e auditimeve sipas institucioneve.

Tabela nr.1 Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:	Nr
Institucione të qeverisjes qendrore	18
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	46
Institucione të tjera financiare, MFE, dhe institucionet vartëse financiare	21
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	28
Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	21
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e teknologjisë së informacionit	14
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performances	57
Totali i subjekteve	205

Grafik nr.1 Subjektet e audituara në periudhën janar – dhjetor 2021




Burimi KLSH

Rekomandimet sipas natyrës

KLSH, gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, administrative dhe disiplinore gjithsej janë 4 251, nga të cilat: 90 janë përmirësime ligjore, 1 087 rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 3 074 rekomandime organizative.

Grafik nr.2 Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën janar- dhjetor 2021



Burimi KLSH

Trajtimi i Letrave të qytetarëve

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2021 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit, duke i orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për ti marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.


Përgjatë kësaj periudhe KLSH ka trajtuar 399 letra dhe ankesa, nga të cilat 117 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 282 ankesa në kompetencë të KLSH, 273 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 9 janë në proces verifikimi.

Trajtimi i kërkesave për të drejtën e informimit

E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe tanië parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë, është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Që me miratimin e ligji të ri nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion nga viti në vit, të ardhura nga individë, subjekte të ndryshme dhe OJF. Vetëm gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2021 janë trajtuar dhe u është përcjellë informacioni i kërkuar 33 kërkesave, të ardhura në adresën e koordinatorit të informimit të KLSH-së.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 13% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik;6% në fushën e taksave, tatimeve, 42% administrimit dhe kthimit të pronës dhe 31% fushave të tjera dhe 8% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafik nr. 3 Fushat kryesore të shqetësimit publik



Burimi KLSH

Kallëzimet Penale

KLSH si një aktor i rëndësishëm në luftën ndaj abuzimeve dhe mashtrimeve financiare me pronën publike, ndaj zyrtarëve të korruptuar, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike, ka adresuar rast pas rasti kallëzime penale në lidhje me “Shpërdorim detyre”, “Shkelje e barazisë në tendera”, etj.

KLSH për vitin 2021 ka përcjellë 14 Kallëzime Penale për 62 persona. KLSH ka pasur në qendër të vëmendjes luftën ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes si dhe të mashtrimit financiar në përdorimin e fondeve dhe të pasurisë publike, duke synuar rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publik, si dhe të efekteve parandaluese nëpërmjet ndëshkimit të personave të cilët janë vlerësuar se gjatë veprimtarisë tyre kanë pasur elementë të veprës penale.

Mbi trajnimet e realizuara gjatë vitit 2021.

Zhvillimi dhe trajnimi i audituesve, është një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, në përmirësimin e kapaciteteve audituese. Trajnimi paraqet një mundësi reale për të zgjeruar bazën e njohurive të të gjithë audituesve.

Në Planin e Zhvillimit Profesional të vitit 2021, është përcaktuar se, KLSH zotëron disa mundësi për realizimin dhe shpërndarjen kohore të trajnimeve, në varësi të rrethanave dhe ngarkesës me angazhimet e programuara audituese, të cilat mund të përfshijnë:

trajnimi i brendshëm, i ofruar nga trajnuesit e brendshëm;

trajnimi i brendshëm, i ofruar nga trajnuesit e jashtëm;

trajnimi i jashtëm;

një përzjerje të trajnimeve të brendshme dhe të jashtme;

E-learning alternativë me kosto efektive, që audituesit publikë dëshirojnë të ndjekin në kohë;

Mentorimi, kryesisht me audituesit e rinj dhe të sapo rekrutuar;

Gjatë vitit 2021, realizimi i tyre është kryer, nëpërmjet platformës “Microsoft Skype”, ku audituesit kanë patur si asistencë Udhëzuesin “Mbi përdorimin e platformës “Microsoft Skype”, të hartuar nga Drejtoria e IT.

Gjatë këtij viti, u realizuan të gjitha trajnimet e programuara për t’u zhvilluar nga burimet e brendshme të KLSH, por dhe më tej, por në aspektin e cilësisë së ofrimit të tyre, por dhe të ndjekjen së tyre në mënyrë aktive nga pjesëmarrësit, duhet të theksojmë se ka vend për përmirësim të moduleve dhe mënyrës së trajnimit, por dhe të impenjimit të audituesve, për të qenë interaktivë, të shkëmbejnë përvojat dhe dijet mes njëri-tjetrit, gjë nga e cila do të përfitonim të gjithë.

Indikatori i trajnimeve.

Në Strategjinë për Zhvillim Institucional 2018-2022, si dhe në Programin e Zhvillimit të Integruar Profesional të miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 14, datë 08.02.2021, është miratuar indikatori 25 ditë/trajnime në vit për çdo auditues.

Trupa audituese e KLSH-së, gjatë vitit 2021, ka realizuar 27 ditë trajnimi/auditues, nga 25 ditë trajnimi/auditues të planifikuara, ku nga audituesit e rinj janë kryer 30.5 ditë mesatare trajnimi. Ky tregues është realizuar në masën 109 % kundrejt objektivit.

Temat e trajtuara, për zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm të INTOSAI-t, ISSAI 100, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit Administrativ të KLSH, në zbatim të Programit të Zhvillimit Profesional të KLSH për vitin 2021, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH 14, datë 08.02.2021, si dhe Programeve mujore të realizuara në përmbushje të detyrimeve të Plan Veprimit, si dhe të programeve të tjera të trajnimit të miratuara në përmbushje të Plan Veprimit të miratuar nga Kryetari i KLSH mbi Rezolutën e Kuvendit për Performancën e KLSH-së-2020 dhe Plan Verimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, mbi rekomandimet e ashkimit Europian, KLSH ka realizuar një sërë trajnimesh, të ofruara brenda institucionit; nga ASPA; nga institucione dhe organizma të huaja, si dhe nga trajnime të ndjekura individualisht nga stafi i KLSH, të fokusuar në Standardet e auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualet e auditimit dhe udhëzues specifikë, në çështje sensitive si prokurimet publike; PPP dhe koncesionet; çështje të korrupsionit dhe masave parandaluese kundër tij-rolit i KLSH-së, etj.

Në vijim disa nga aktivitetet e kryera.

-Aktivitete të kryera në bashkëpunim me organizma të huaja, sipas punë dhe raportim i Sektorit të Publikimeve, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Periudha	Tema
Janar	1. Takimi i SAI-eve për auditimin e mbetjeve plastike
Shkurt	1. Aktiviteti i Sigma-s për çështjet anti-covid
Mars	1. Takimi i 11 i Task Forcës së EUROSAL-t për Auditimin dhe Etikën; 2. Trajnimi i Auditimit Paralel të Performancës 3; 3. Takimi për Auditimin paralel "Menaxhimi i Mbetjeve Plastike"
Prill	1. Webinar-i për manualin e auditimit të detyrimeve të prapambetura; 2. Konferesi i XI i EUROSAL-t; 3. Sesiioni i Pranverës i Grupit të Punës së EUROSAL-t për Auditimet e Mjedisit; 4. Trajnimi i Auditimit Paralel të Performancës 3.
Maj	1. Grupit të Punës së IT-së pranë EUROSAL- seminar me temë: "Nga kodifikimi tek veprimi - SAI-et eksplorojnë botën e inteligjencës artificiale"; 2. Takimi për auditimin e ndotjes së deteve; 3. Takimi për auditimin paralel "Menaxhimi i Mbetjeve Plastike"; 4. Konferenca e SAI-t të Polonisë me temë "Pavarësia e SAI-eve".
Qershor	1. Seminari i Projekt Grupit të EUROSAL për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve; 2. Takimi i parë për auditimin e koordinuar për Auditimin e Bashkive; 3. Sesiioni i OKB-se me INTOSAL: "Roli i detyrueshëm i institucioneve supreme të auditimit për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në kohët moderne"; 4. Trajnimi i Auditimit Paralel të Performancës 3; 5. Seminari i SIGMA-s për prezantimin e udhëzuesit për inspektimin financiar; 6. Simpoziumi OKB/INTOSAL me temë "Puna gjatë dhe pas pandemisë: Përvojat e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) për forcimin e institucioneve efektive dhe arrijten e shoqërive të qëndrueshme "; 7. Seminari i tretë i SIGMA-s lidhur me situatën e Covid-19.
Shtator	1. Seminari i SAI të Indonezisë me temë "Auditimet e Teknologjisë së Informacionit në Epokën e Industrisë; 4.0: Mundësitë dhe Sfidat"; 2. Trajnimi i Auditimit Paralel të Performancës 3; 3. EUROSAL Qëllimi strategjik 1, Bashkëpunimi profesional mbledhja e 5-të; 4. Trajnimi në kuadër të iniciativës së IDI-t "Strategjia, Matja e Performancës dhe Raportimi SPMR" - Prezantimi i Kornizës së matjes së performancës së SAI-eve dhe SPMR; - Domain A/B/C; - Domain D/E/F - Planifikimi për angazhimin e kornizës së performancës PMF të SAI-t/ Angazhimi gjinor i subjektit të interesuar - Webinar me pyetje përgjigje dedikuar subjekteve të interesuar (20-24.09.2021; 28-30.09.2021 & 1/4/8.10.2021) 7. Takimi i audituesve të NATO-s, 8. Takimi i personave të kontaktit të BE-së,
Tetor	1. Takimi i 19 i Grupit të Punës së EUROSAL-t për Auditimet e Mjedisit; 2. Takimi i Komitetit të Kontakteve; 3. Takimi i parë i ekspertëve për hartimin e dokumentit për intensifikimin e marrëdhënieve midis SAI-eve dhe agjencive anti-korrupsion që do zhvillohet në Vjenë; 4. Planifikimi për angazhimin e kornizës së performancës PMF të SAI-it / Angazhimi gjinor i subjektit të interesuar;

	<p>5. Korniza e matjes së performancës së SAI-eve, sesion pyetje dhe përgjigje;</p> <p>6. Webinar dedikuar subjekteve të interesuar;</p> <p>7. Webinar me pyetje dhe përgjigje dedikuar subjekteve të interesuar, 20-24 shtator (5 ditë); 28-30 shtator (3 ditë); 1, 4, 8 tetor (3 ditë); nëntor (1 ditë).</p>
Nëntor	<p>1. Takimi i 5 i Task Forcës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive;</p> <p>2. Tryezë e rumbullakët për ligjin e ri të prokurimit publik dhe auditimin, SIGMA/OECD;</p> <p>3. Takimi me ekspertët e SAI-it Norvegjez për auditimet e IT-së;</p> <p>4. Takimi me ekspertët norvegjez për auditimet e Mjedisit,</p> <p>5. Takimi i 14 i grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet IT;</p> <p>6. Ligji i Ri i Prokurimit Publik: proceset, pikat kritike dhe modalitetet e investigimit, ANAC;</p> <p>7. Dhënia e kontratës dhe implementimi: dëmi ekonomik lidhur me procedurat- kostot e përcaktuara dhe kostot efektive të implementimit të kontratës;</p> <p>8. Takimi i Grupit të Punës së EUROSAT për auditimin e Fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat;</p> <p>9. Samiti i IDI-t me temë "Cili është impakti i auditimit t; SAI-eve;</p> <p>10. Takimi me ekspertët e IDI-t për vetëvlerësimin e performancës së KLSH.</p>
Dhjetor	<p>1. Takimi me ekspertët e SAI-t të Norvegjisë për auditimet IT;</p> <p>2. Konferenca me temë "E ardhmja e Anti-Korrupsionit - risitë e integritetit përmes teknologjisë dhe partneritetit";</p> <p>3. Trajnimi i Auditimit Paralel të Performancës 3.</p>
Totali	40 aktivitete, të shtrira në 107 ditë dhe realizuar 287 ditë auditues trajnimi.

Trajnime të organizuara nga ASPA

Gjatë vitit 2021, stafi i KLSH ka qenë prezent në trajnime të zhvilluara nga ASPA, si dhe ka marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara mbi grup-temat e mëposhtme. Nga stafi i KLSH janë realizuar 1,858 ditë staf/trajnimi.

Auditimi financiar dhe pasqyrat financiare; PPP/koncensione; Prokurimi publik; Trajnime anti-korrupsion; Ligji për nëpunësin civil dhe të drejtën administrative; Komunikimi, etika dhe niveli menaxherial; Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli/Auditimi Brendshëm; Vetëqeverisja vendore; Buxhet dhe planifikim buxhetor; Fondet IPA; Vlerësim projektsh; Teknologji Informacioni; E drejtë Europiane;

KLSH ne vijim me burimet financiare disponibel do të vazhdojë përpjekjet institucionale të cilat synojnë modernizimin dhe reformimin e institucionit me qëllim që të reflektojmë tiparet dhe standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI dhe fokusimin e veprimtarisë audituese me impakt, forcimin e llogaridhënës publike, të integritetit, transparencës institucionale.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

Viti 2021

Në 000/Leke

2021

VITI

Emri i G Program	Kontrolli i Larte i Shtetit Programi Veprimtari Audituese e KLSH	Kodi i Grupit Kodi i Programit	1024001 01120					
Shpenzimet e Institucionit								
Titulli	Programi	Fakti i Vitit paraardhes Viti 2020	PBA Viti 2021	Plan Fillestar Viti-2021	Plan i Rishikuar Viti 2021	Plani i Periudhes Progressive	Fakti Vitit 2021	Diferenca
01120	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	364,981	427,353	433,700	391,083	391,083	348,982	-42,101
								0
								0
								0
								0
Totali i Shpenzimeve		364,981	427,353	433,700	391,083	391,083	348,982	-42,101
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		364,981	427,353	433,700	391,083	391,083	348,982	-42,101

Pergjegjes Sektori Finance	Alketa Kalleshi	Valbona Gaxha
	Firma <i>Alketa</i>	Firma <i>Valbona</i>
	Data 25/02/2022	Data 25/02/2022



Viti 2021

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

Emri i Grupi	Kontrolli i Larte i Shtetit	Kodi i Grupit	1024001
Programi	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	Kodi i Programit	01120

Niv. 000/lekë

Artikulli	Programi	Fakti i Vitit paraardhes Viti 2020	PBA Viti 2021	Plan Fillestar Viti-2021	Plan i Rishikuar Viti 2021	Plani i Perudhes Progressive	Fakti Vitit 2021	Diferenca
600	Paga	257,974	316,000	269,000	253,000	253,000	247,281	-5,719
601	Sigurime Shoqërore	40,143		42,000	42,000	42,000	40,073	-1,927
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	50,823	82,500	80,850	52,850	52,850	51,593	-1,257
605	Transferta Korrente të Huaja	118		150	150	150	61	-89
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,160		1,847	1,847	1,847	1,273	-574
Non-Totali	Shpenzime Korrente	351,218	398,500	393,847	349,847	349,847	340,281	-9,566
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	13,763	20,000	20,000	20,000	20,000	7,586	-12,414
232	Transferta Kapitale							0
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	13,763	20,000	20,000	20,000	20,000	7,586	-12,414
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara		8,853	19,853	19,853	19,853	0	-19,853
232	Transferta Kapitale							0
231	Grand I Huaj				1,383	1,383	1,115	-268
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	8,853	19,853	21,236	21,236	1,115	-20,121
Totali	Shpenzime Kapitale	13,763	28,853	39,853	41,236	41,236	8,701	-32,535
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		364,981	427,353	433,700	391,083	391,083	348,982	-42,101

Pergjegjes Sektori Finance	Alketa Kalleshih	Valbona Gaxhja
	Firma	Firma
	Data 25/02/2022	Data 25/02/2022
	Sekretari i Përgjithshëm	


ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhës i realizimit të kërësive të performancës/prodhuesve të programit"

Emri i Grupit	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Kodi i Grupit	1024001
Programi	Programi Veprimtari Audituese e KLSH	Kodi i Programit	01120

Viti 2021
Periudha: Janar-Dhjetor

Kodi	ne 000/ëke	I			II			III			IV			Luhatjet ne Kostom per Njesi		
		Sasia Faktike Viti 2020	Shpenzimet (Viti 2020)	Kosto per Njesi (Viti 2020)	Sasia (sipas planit Viti 2021)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2021)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
A	Auditime te kryera	73	351,216	4,811	148	393,847	2,661	120	349,847	2,915	158	340,281	2,154	-2,658	-507	-762
B	Blerje paisje kompjuterike	127	13,493	106	35	7,600	217	212	4,200	20	212	3,556	17	-89	-200	-3
	Rikonstrukton anijente				1		0	1	3,400	3,400	1	1,420				
C	Blerje paisje zyre	22	272	12	21	400	19	4	400	100	4	310	78	65	58	-23
D	Blerje Automjete				3	9,700	3,233	1	9,700	9,700	0	0	0			
G	Kosto Lokale				1	2,300	2,300	1	2,300	2,300	1	2,300	2,300	2,300	0	0
	Financim i Huaj					19,853			21,235			1,115				
						433,700			391,082			348,982				

Pergjegjes Sektori Finance	Alketa Kalleshi Firma	Sekretari i Pergjithshem	Valbona Gaxha Firma
	Data 25/02/2022		Data 25/02/2022



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektive te politikave te politikave se programit"

Kodi i Programit	1024001	Emerimi i programit:	Veprimtari Auditues e Kontrollit te Larte te Shtetit						Komente
Qellimi 1	" Ushtrimi i veprimtarise audituese ne nje linje me standartet nderkombetare te auditimit mbi perdorimin ne efektivitete, efience dhe ekonomicitet te fondeve publike ne funksion te rritjes se pergjigjshmerise se menaxhimit te financave e pasurise publike duke sjelle vlere te shtuar per shoqerine dhe ndryshim ne jeten e qytetareve"		**Treguesit e performancës/Produktit:						
Objektivi 1.1	Objektivat e politikës	Kodi i Treguesit te Performances /Produktit	Emerimi i Treguesit te Performances***/Pro duktit	Niveli faktik i vitit 2020	Niveli i planifikuar ne vitin 2021	Niveli i rishikuar ne vitin 2021	Niveli faktik ne fundit 2021	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
	"Mbuhimi me auditime financiare perputhshmerie dhe performace i njeseve te sektorit publik nepermjet konsolidimit te auditimeve te perputhshmerise rritjes se auditimeve financiare dhe te performances ne nje linje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ISSAI"	A	Auditime te kryera	73	120	120	158	132%	Përdorimi efektiv i fondeve buxhetore ne funksion të modernizimit institucional në një linjë me standartet ndërkombëtare INTOSAI dhe praktikat më të mira, ngritjen e kapaciteteve audituese, ushtrimi i veprimtarisë audituese në përmbushje të detyrimit ligjor kushtetues sipas programit të miratuar nga Kryeshteti i KLSH-së, si dhe garantimi i auditimeve me cilësi të lartë dhe efektivitet. Kryeshteti e Auditimeve të përputhshmerisë, të certifikimit të pasqyrave financiare, të teknologjisë së informacionit dhe të performancës, konform standardeve ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI.
Objektivi 1.1	Ofrimi i kushteve cilësore të punës për zhvillimin e aktivitetit auditues të KLSH-së nëpërmjet investimit për ngritjen e godinës dhe përmirësimin e infrastrukturës akomoduese me paisje dhe orëndi të nevojshme, në funksion të ushtrimit normal të veprimtarisë institucionale.								
		A	Blerje paisje kompjuterike	127	212	212	212	100%	
		B	Blerje paisje zyre	22	4	4	4	100%	
		C	Blerje Automjete	0	3	1	0		
		D	Rikonstrukton Ndertesa			1	1	100%	

Pergjegjesi Sektori Finance	Alketa Kalçiqi Firma	Sekretari i Pergjithshem	Valbona Gaxha Firma
	Data 25/07/2022		Data 25/02/2022

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"



Viti 2021

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Kontrolli i Larte i Shtetit				Kodi i Grupit			
		Vlera e plotë e Projektit.	Viti i fillimit te Projektit	Viti i përfundimit te Projektit	Buxheti 2021 Kontraktuar.	Plani i buxhetit vitit 2021	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Realizimi për periudhën e raportimit	Realizimi Progressiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale
M240010	Pajsje te ndryshme zyre	400	2021	2021	400	400	310	310	310
M240009	Blerje paisje kompjuterike	4,200	2021	2021	7600	4,200	3,556	3,556	3,556
	Rikonstruksion ambjentet	3,400	2021	2021	9700	3,400	1,420	1,420	1,420
M240002	Blerje automjete	9,700	2021	2021	2300	9,700	0	0	0
M240012	kosto Lokale kompjuterike	2,300	2021	2021	1381	2,300	1,381	1,115	1,115
		20,000			21,381	21,381	8,967	8,701	8,701

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant	Vlera e plotë e Projektit.	Viti i fillimit te Projektit	Viti i përfundimit tw Projektit	Buxheti I Kontraktuar	Plani i buxhetit vitit 2021.	Realizimi për periudhën e raportimit	Realizimi Progressiv nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale
19AA401	Forcimi i rolit të Auditimit të Jashëm në mbikqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri	Grant/	24519	2021	2022	0	19853	0	0	0
	Blerje paisjeve kompjuterike	Grant/	1383	2021	2021	1,381	1,381	1,115	1,115	1,115
								1115		

Përgjegjesi Sektorial Finance	Emri	Alketa Kalleshi	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Valbona Gaxha
	Firma			Firma	
		Data 25/02/2022			Data 25/02/2022

